

UNIVERSITETI I GJAKOVËS  
“FEHMI AGANI”  
FAKULTETI FILOLOGJIK-GJAKOVË  
PROGRAMI: GJUHË SHQIPE



**PUNIM DIPLOME**

Tema: Ndajfoljet rrethanore te vepra  
“Darka e gabuar” e Ismail Kadaresë

*Mentori:*

*Prof. dr. asoc. XHELADIN ZYMBERAJ*

*Kandidatja:*

**MIRANDA KRASNIQI**

Gjakovë, 2018

## PËRMBAJTJA

- Falënderim-----	3
- Abstrakt-----	4
- Parathënie-----	5
<b>KREU -I-</b>	
1. Hyrje-----	6
1.1 Ç'është morfologjia?-----	8
1.2. Pjesët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme---	9
<b>KREU -II-</b>	
2. Ndajfoljet-----	13
2.1. Formimi i ndajfoljeve-----	15
2.2. Ndajfoljet rrethanore-----	17
2.3. Llojet e ndajfoljeve rrethanore-----	20
2.3.1. Ndajfoljet e kohës-----	21
2.3.2 Ndajfoljet e vendit-----	23
2.3.3 Ndajfoljet e shkakut-----	24
<b>KREU -III-</b>	
3. Jeta dhe veprimtaria letrare e Ismail Kadaresë--- -----	25
3.1 Darka e Gabuar-----	26
3.2 Ngjarja-----	27
- Përfundim-----	28
- Literatura-----	29
- Jetëshkrimi-----	30

- **FALËNDERIME DHE MIRËNJOHJE**

Falënderoj Prof. dr. Xheladin Zymberaj për orientimin dhe udhëheqjen profesionale të studimit. Me vizionin dhe sugjerimet shkencore ai u bë motivuesi dhe mbështetësi kryesor për ndërtimin e strukturës së studimit, thellimin e mendimit dhe sigurimin e informacionit të nevojshëm e konkret për seksionet specifike, duke mundësuar realizimin me sukses të studimit. I jam shumë mirënjohëse për këmbënguljen e tij për të nxjerrë më të mirën prej meje si dhe për kontributin në drejtim të rritjes së nivelit argumentues mbi ndikimin pozitiv të programeve të fëmijëve.

Së fundi, shpreh mirënjohje për bashkëshortin, Jetonin, dhe familjen, që më kanë mbështetur e inkurajuar duke më kompensuar në detyrimet e statusit familjar.

- **ABSTRAKT**

Ky punim diplome si tërësi ka pretendim që ta trajtojë rëndësinë e ndajfoljeve rrethanore në përgjithësi e në veçanti klasifikimin e tyre, në të gjitha format e të shprehurit duke filluar që nga ai popullor e gjer tek të shprehurit artistik. Pasi që ndajfoljet rrethanore janë gjymtyrë të rëndësishme të fjalës dhe fjalisë, një vështrim i përgjithshëm është bërë edhe për fjalinë e thjeshtë duke paraqitur situatat se si shtrihet nëpër fjali të thjeshta të të gjitha llojeve. Pastaj një vështrim të përgjithshëm e kam bërë për klasifikimin dhe shtrirjen e tij. Për ndajfoljet rrethanore kam bërë përpjekje maksimale që ta trajtoj në mënyrë shkencore duke hulumtuar materialin e deri te paraqitja sa më konkrete e shembujve me qëllim që fjala dhe fjalia si tërësi dhe si pjesë përbërëse e saj të kuptohet lehtë dhe të aplikohet drejtë nga të gjithë shqipfolësit. Nuk është lënë anash ndërlidhja e klasifikimit me kohën, vendin dhe shkakun, kur këto shprehen dhe paraqesin pasiguri te analizuesi, kështu që janë dhënë mjaft hollësi për karakteristikat dalluese të të tri mënyrave.

## - PARATHËNIE

Te prof. Dr. Xheladin Zymberaj për punim diplome e kam zgjedhur këtë temë:

“Ndajfoljet rrethanore – në veprën *"Darka e gabuar"* të shkrimtarit tonë të shquar Ismail Kadare. Puna ime e parë ka qenë që materialin, i cili ndërlidhet drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë me ndajfoljet, ta sistemoj, ta klasifikoj dhe ta parashtroj në mënyrë sa më të qëlluar e të kuptueshme. Jam orvatur që ndajfoljet rrethanore ti studioj sa më mirë me qëllim që punimi të ketë vlerë dhe cilësi estetike, morfologjike dhe gramatikore e gjuhësore. Gjithmonë duke u konsultuar me *Gramatikën e gjuhës shqipe I* dhe gramatika të tjera, ashtu siç e parashohin normat standarde të gjuhës. Gjatë shpjegimit të ndajfoljeve rrethanore, për çdo të dhënë, kam marrë shembuj konkretë, shumicën e të cilëve i kam hasur tek vepra *"Darka e gabuar"*.

## KREU –I-

### 1. HYRJJE

Mësimi i gjuhës shqipe ndër vite është shoqëruar me ndryshime të rëndësishme të cilat kanë prekur pjesën përmbajtësore të kësaj lënde si dhe pjesën e procesit dhe metodologjisë të mësimdhënies dhe të nxënies. Këto ndryshime kanë përbërë risi të fuqishme didaktike, të cilat i kanë dhënë mësimin të gjuhës shqipe një panoramë të re, si në planin kurrikular përmbajtësor, ashtu edhe në atë të procesit të mësimdhënies dhe të nxënies.

Sigurisht i gjithë ky proces ndryshimesh, hap pas hapi dhe vit pas viti, ka kaluar përmes një praktike vlerësuese nga aktorët që e kanë kërkuar dhe zbatuar atë. Duhet të pranojmë se një kurrikul sado e avancuar të jetë, duhet praktikuar në shkollë për t'u bërë pjesë e ndryshimit dhe e mentalitetit të ri nga mësuesit, të cilët e zbatojnë dhe e përkrahin atë. Kjo do të thotë se me gjithë ndryshimet dhe risitë e përcjella kanë dalë në pah problematika të ndryshme në lidhje me arritjet në fjalë. Shkolla dhe mësuesit kanë për detyrë që, në tërë veprimtarinë e tyre, të nxitin nxënësit për të fituar e zotëruar kompetenca gjuhësore, për t'i bërë këto kompetenca më të pasura, më të këndshme dhe më të larmishme, në mënyrë që ata (nxënësit) të krijojnë përvojat e tyre, duke i dhënë kuptim të menduarit, nëpërmjet të folurit me gojë dhe të shprehurit me shkrim.

*“Lënda e gjuhës shqipe ka një rëndësi të veçantë në kurrikulën e arsimit parauniversitar. Nëpërmjet kësaj lënde, nxënësit: fitojnë njohuri dhe demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime rreth sistemit gjuhësor të shqipes; fitojnë njohuri dhe demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime për të komunikuar në mënyrën e duhur (të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit).”<sup>1</sup>*

Në këtë punim diplome të titulluar: “Ndajfoljet rrethore – në veprën “Darka e gabuar” të shkrimtarit tonë të shquar Ismail Kadare, trajtohen në të gjitha aspektet ndajfoljet rrethore.

Vet emërtimi i temës përkufizon objektin e studimit. Ndajfoljet rrethore në romanin “Darka e gabuar” do të vështrohen në aspektin teorik dhe praktik. Në aspektin praktik, ndajfoljet rrethore në këtë roman do të interpretohen sipas kuptimit dhe funksionit, ndërsa në aspektin teorik do të trajtohen llojet e ndajfoljeve rrethore dhe klasifikimi i tyre, sipas kuptimit dhe funksionit, gjë që do të thotë, se gjatë punës sime do të zbatojmë metodën e parashikimit, metodën krahasuese dhe metodën statistikore.

---

<sup>1</sup> Kurrikula e gjuhës shqipe, MASHT, Prishtinë, 2015

Përzgjedhja e kësaj teme përpunimi, ka për qëllim për të parë kohësinë e këtyre ndajfoljeve rrethore në këtë roman.

Përcaktimi për autorin Ismail Kadare dhe gjuhën e veprës së tij i përgjigjet aq më tepër për faktin se Kadareja tashmë identifikohet, si shkrimtari më i veçantë i letrave shqipe. Veçantia e tij krijuese e reflekton dukshëm edhe në aspektin gjuhësor. Në pjesët e kësaj teme diplome, do të interpretohen teoritikisht ndajfoljet e kohës, të vendit dhe të shkakut, përdorimi i tyre dhe aspekti funksional i tyre në veprën “Darka e gabuar”. Ndërsa për punën e bërë dhe njohuritë e fituara gjatë ligjëratave i jam mirënjohës mentorit tim prof. Xheladin Zymeraj.

## ***1.1. Ç' është morfologjia?***

Gjuhëtarët e ndryshëm kanë dhënë mendime të përafërta me njëri – tjetrin. Dallimi qëndron në atë se, lënda që trajtohet, cilit nivel të nxënësve apo studiuesve u dedikohet kjo pjesë e gjuhës. Ja disa shembuj se si është përkufizuar morfologjia:

Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë i Akademisë së Shkencave i Republikës së Shqipërisë për morfologjinë e jep këtë definicion:

"Morfologjia (nga greqishtja morfé = formë dhe logos = fjalë, dije) është ajo pjesë e gramatikës, që merret në radhë të parë me studimin e trajtëformimit, d.m.th. me studimin e formave të ndryshme, që marrin fjalët e lakueshme (emrat, mbiemrat, përemrat dhe numërorët) ose të zgjedhueshme (foljet), si dhe me studimin e kuptimeve të këtyre formave<sup>2</sup>.

### Morfologjia

1. Trajta e jashtme dhe ndërtimi i diçkaje, mënyra si lidhen ndërmjet tyre pjesët përbërëse të saj; shkenca që studion trajtën dhe ndërtimin e brendshëm të diçkaje.

2. Pjesë e gramatikës, që merret me studimin e trajtave të fjalëve, si edhe të kategorive gramatikore të tyre; sistemi i trajtave të fjalëve të një gjuhe.

Sipas mendimit tim, morfologjia është pjesa ekzekutive që zbaton në praktikë të gjitha rregullat morfologjike, fonetike, drejtshkrimore, kuptimore dhe logjike.

Pavarësisht definicioneve, ka përplot tekste të gjuhës që nuk i japin rëndësi fare fjalës morfologji, por merren drejtpërdrejt me lëndën e saj që është fjala, parafjala, lidhëza dhe pjesëza. Jepen shembuj nga më të ndryshmit për ta pasqyruar dhe shpjeguar sa më mirë në mënyrë që të kuptohet sa më lehtë fjala në fjali, të ndërliidhen fjalët dhe fjalitë në mes tyre gjatë komunikimit të përditshëm në të gjitha mënyrat e ligjërimit dhe të të shkruarit e të gjitha formave të mundshme.

---

<sup>2</sup> Gramatika e gjuhës shqipe I, ASHSH – Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë 2002, fq. 29;



## 1.2. Pjesët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme të ligjëratës

Nga gjuhën shqipe formohen si pjesë të pandryshueshme të ligjerates ashtu edhe pjesë të ndryshueshme të saj. Gjejmë të formuar me konversion: emra, mbiemra, ndajfolje, parafjalë, lidhëza, pasthirrma dhe ndonjë përemër. Më poshtë gjenden shembuj më konkretë për disa nga modelet kryesore te konversionit:

mbiemër:	Letër e bardhë	→	emër:	<i>E bardha</i> e syrit
emër:	Bën punën e armikut	→	mbiemër:	Ushtri <i>armike</i>
emër:	Kush ka ditën, të mos presë mesditën	→	ndajfolje:	<i>Ditën</i> të lëpin këmbët natën të ngul dhëmbët
parafjalë:	Luftoi kundër armikut	→	ndajfolje:	I rrinte <i>kundër</i>
ndajfolje:	I qëndroi përballë shkollës	→	parafjalë:	Gjendet <i>përballë</i>
emër:	Kafshoi buzën	→	parafjalë:	<i>Buzë</i> detit
ndajfolje:	Ku shkon?	→	lidhëz:	Do të vijmë <i>ku</i> të shkosh ti.

Nisur dhe nga fakti se shërben si mënyrë fjalëformimi për shumë pjesë të ligjeratës, veçanërisht për pjesët e pandryshueshme të saj, kjo dhe për faktin se mënyrat morfologjike nuk veprojnë te fjalët shërbyese, mund të thuhet se luan një rol me rëndësi në sistemin fjalëformues të gjuhës shqipe.<sup>3</sup>

Në mbiemra kalojnë pa marrë ndonjë ndajshitesë emra dhe disa ndajfolje, si ato të formuara me prapashtesat –çe dhe –ishte si: armik, bullgar, çalaman, elbasanas, kukull, mishngrënës etj; fshatçe, pleqërishte etj. Në gjuhën shqipe ndajfoljet formohen edhe nga rasat e ndryshme të emrave, si dhe nga foljet, kryesisht nga pjesorja e foljes dhe më pak nga përcjellorja mohore e mënyrës.<sup>4</sup> fare, herët, krejt; ditën, natën, etj.; motit, sheshit, një nate etj.; fshehur, prerë, shkoqur; papritur, padashur etj.

Për një tjetër ndryshim mes fjalëve të formuara me parashtesim dhe atyre formuar me përngjitje, sipas Hysës, flet dhe natyra leksikogramatikore e këtyre fjalëve, ku dihet se pjesa dërrmuese e fjalëve të përngjitura janë pjesë të pandryshueshme të ligjeratës, ndërsa fjalët e formuara me parashtesim janë pjesë të ndryshueshme të ligjeratës. Janë ndoshta këto lidhje të forta gjenetike midis përngjitjes, parashtesimit dhe kompozimit, ato që kanë bërë që disa gjuhëtarë të hershëm të flasin për përngjitje duke përfshirë në të fjalë të përbëra, kompozita,

<sup>3</sup> Po aty, “Gramatikën e gjuhës shqipe, 1” (1995 dhe 2002)

<sup>4</sup> “Format e pashtjelluara te foljes në gjuhën e sotme shqipe”, Tiranë, 2000

siç ka ndodhur me S. Frashërin në punimin e tij “Shkronjëto e gjuhës shqipe”, në të cilin ai, teksa flet për “mbiemrat e ngitura”, jep si shembuj kompozitat mbiemërore: syzi, faqekuq, jetëmadh, zemërgur, ditëgjatë e syhirë.<sup>5</sup>

Siç mund të vihet re si nga përkufizimi ashtu edhe nga shembujt, nëpërmjet përngjitjes formohen fjalë të reja pa pjesëmarrjen e mjeteve fjalëformuese siç janë ndajshitesat, nyjat e përparme apo temat fjalëformuese, duke bërë që kjo mënyrë fjalëformimi të klasifikohet si mënyrë jomorfologjike krahas konversionit me të cilin ka lidhje të ngushtë për vetë faktin se, në momentin që leksikalizohet një togfjalësh, një tog parafjalor, një grup fjalësh apo edhe një fjali e tërë, siç ndodh në rastin e “tungjatjeta”, togfjalëshi, grupi i fjalëve apo dhe vetë fjalia merr vlerën e një pjese ligjrate të caktuar. Ajo sipas rastit emërzohet “thashethem”, mbiemërzohet “bardhezi”, ndajfoljëzohet “githmonë”, foljëzohet “vërej” e kështu me rradhë. Kur ndodh procesi i përngjitjes, i shkrirjes së gjymtyrëve të togfjalëshit, apo pjesëve të fjalisë në një njësi të vetme, pra kur ndodh njëfjalëzimi, togu i fjalëve formësohet gramatikusht duke marrë trajtëformime të veçanta nëse fiton vlerën e një pjese të ndryshueshme të ligjeratës. Ai silllet si emër, folje apo mbiemër, sipas rastit, ose si pjesë e pandryshueshme e ligjeratës kur fiton vlerën e njëres prej tyre. Pra fjalët e përngjitura shprehin një kuptim leksikor të caktuar, i cili si rregull është i barabartë me kuptimin e togut nga ka dalë fjala e përngjitur dhe nëse ajo është një fjalë kuptimplotë atëherë ajo përdoret si gjymtyrë me vete në fjali. Edhe në planin sintaksor fjalët e përngjitura kryejnë të njëjtat funksione sintaksore si dhe pjesët e ligjeratës ku ato bëjnë pjesë. Karakteristikë e tyre është edhe theksi i vetëm që ato kanë, i cili pavarësisht nga numri i njësive përbërëse të fjalës së përngjitur bie gjithnjë në elementin e fundit, duke e formësuar kështu gjithë fjalën e përngjitur edhe nga pikëpamja fonetike.

Fjalët e përngjitura janë më tepër karakteristikë e pjesëve të pandryshueshme të ligjeratës, pasi ndeshen më shumë mes tyre, por jo vetëm. Ato mund të jenë:

ndajfolje: gjithmonë, gjithnjë, gjithkund, gjëkund, asgjëkund, kurdo, sido, ngado, kurdoherë, ngandonjëherë, diku, dikur, asnjëherë, menjëherë, matanë etj.;

parafjalë: përmbi, nëpër, përveç, sipas, simbas, ndërmjet, nëpërmjet etj.;

lidhëza: gjersa, derisa, porsa, sesa, kurse, nëse, ndonëse, sikurse, pasi, meqë, meqenëse, mirëpo, megjithatë, megjithëkëtë etj.;

---

<sup>5</sup> S. Frashëri, Shkronjëto e gjuhës shqipe, Bukuresht, 1886, f. 38

pjesëza: pale, posi, siç, thuajse, kushedi etj.;

pasthirrma: faleminderit, tungjatjeta, mirupfshim etj. Por me anë të përngjitjes janë formuar edhe disa përmra të pacaktuar: kushdo, cilido, çdo, çfarëdo, ndokush, ndonjëri, ndonjë, sekush, akëcili, askush, asnjë, asgjë, kurrkush, kurrjë, gjithëkush, gjithsecili, tjetërkush, shumëkush, gjësendi, gjëkafshë etj.

numërorët: njëmbëdhjetë, dybëdhjetë, trembëdhjetë, katërbëdhjetë, pesëmbëdhjetë, gjashtëmbëdhjetë, shtatëmbëdhjetë, tetëmbëdhjetë dhe nëntëmbëdhjetë pak emra: farëefis, gjëegjëzë, thashethem, ecejake etj. shumë pak folje si bëzaj, vërej apo përsëdyt si dhe ndonjë mbiemër si kuqezi.

Ndërsa në Gramatikën e gjuhës shqipe<sup>6</sup>, në formën e një shënimi gjejmë ndajfoljen kundër të formuar me konversion nga parafjala kundër. Gjithashtu me konversion janë formuar edhe disa përemra të pacaktuar si kush nga përemri pyetës kush, përemrat gjë dhe njeri nga emrat përkatës gjë dhe njeri. Me anë të kësaj mënyre fjalëformimi nuk formohen vetëm pjesë të ndryshueshme të ligjeratës, por edhe pjesë të pandryshueshme. Kështu formohen disa parafjalë jo të parme të gjuhës shqipe, të cilat përkojnë formalisht e deri diku edhe semantikisht, me pjesën e ligjeratës nga e cila kanë dalë. Parafjalë ndajfoljore, të cilat përbëjnë dhe grupin më të madh të parafjalëve formuar me konversion janë: afër, anës, poshtë, rreth,<sup>7</sup> tej etj.; parafjalë emërore: anë, ballë, bri, faqe, rrëzë etj. Si parafjalë foljore që dalin nga pjesoret e foljeve, përveç parafjalës falë, Çeliku rendit edhe katër të tjera: përfshirë, përjashtuar, shkuar dhe kaluar; si dhe pak pjesore që janë duke u kthyer në parafjalë si: shtuar, drejtuar, kushtuar.<sup>8</sup> Gjithsesi këto fjalë nuk janë pranuar në “Fjalorin shqipes së sotme” si parafjalë. Me konversion formohen gjithashtu edhe lidhëza, si p.sh. lidhëzat përemërore dhe ato ndajfoljore: që, sa, se, formuar nga përemrat përkatës lidhorë e pyetës dhe lidhëzat ku, kur, nga, tek, veç dalë nga ndajfoljet përkatëse. Ne gjuhën shqipe kemi dhe lidhëzat daç e qoftë të cilat kanë dalë nga foljet dua dhe jam. Formohen disa pjesëza ardhur kryesisht nga lidhëza: dhe, edhe, porsa, pra, sa etj.; nga ndajfolje: gati, plot, rreth, vetëm etj.; nga pasthirrma: a, e, ë, de etj. Si pasthirrma të formuara me konversion në shqipe kemi disa forma të ngurosura të emrave dhe mbiemrave të emëruar si: forca, korba, qyqja, e zeza etj.

<sup>6</sup> Po aty, 1 Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë, 1995, f. 384

<sup>7</sup> Sh. Demiraj në “Morfolojia e gjuhës së sotme shqipe, II” (1961, f. 271)

<sup>8</sup> Çeliku dhe të tjerë, Gramatika praktike e gjuhës shqipe, Tiranë, 2004, f. 227

Në rolin e gjymtyrës përcaktuese të fjalës së përbërë mund të marrin pjesë si pjesë të ndryshueshme ashtu edhe pjesë të pandryshueshme të ligjeratës, si p.sh.: emra, mbiemra, folje, ndajfolje, numërorë, përemra, apo parafjalë. Gjymtyra e dytë, e cila është dhe fjala e përcaktuar, është dhe tema mbështetëse e gjithë kompozitës, pasi ajo e formëson gramatikisht kompozitën duke shprehur kategoritë gramatikore të saj dhe duke përcaktuar në këtë mënyrë dhe përkatësinë në pjesë ligjrate të fjalës së përbërë. Pra nëse fjala e përcaktuar është një emër, një mbiemër, një folje apo ndajfolje, edhe kompozita e re e formuar do të jetë respektivisht, emër, mbiemër, folje apo ndajfolje.

## KREU –II-

### 2. Ndajfoljet

Ndajfoljet luajnë përgjithësisht një rol të rëndësishëm në konektivitetin e tekstit. Në gjuhësinë shqiptare kjo njësi deri tani është trajtuar si një pjesë e ligjëratës, e cila “*emërton një tipar të veprimit a të gjendjes, rrethanat në të cilat vërtetohet ky veprim, ose tregon shkallën e një cilësie a të një rrethane ose intensitetin e veprimit.*”<sup>9</sup> Pra, ky studim i saj është përqendruar më tepër në tiparet morfologjike dhe semantike që ajo shfaq në fjali.

Objekti i punimit tim është i mirënjohur dhe i mirëtrajtuar por shtruarja dhe zgjidhja e problemeve të një teme të tillë për gjuhën shqipe, mbështetur në materiale të gjera, kërkon një studim të thellë. Ndajfolja është bërë objekt studimi sintetik në çdo gramatikë shkollore e jashtë shkollore. Duke u thelluar në materialet e shumta, të nxjerra nga letërsia artistike e gjinive të ndryshme si dhe nga folklori, të tërheqin vëmendjen mjaft çështje të rëndësishme për t’u trajtuar rreth ndajfoljeve. Të tilla janë: problemi i klasifikimit në klasa të veçanta e përcaktimi i kufijve të këtyre klasave, problemi i shkallëve të ndajfoljeve, përcaktimi i ndajfoljeve të thjeshta dhe lokucioneve ndajfoljore që përdoren në shkallë të ndryshme dhe i atyre që nuk formojnë shkallë, duke mos lënë jashtë këtu edhe afërsitë që vihen re në këtë pikë me mbiemrat. Problemet që lidhen me origjinën dhe formimin e ndajfoljeve janë të shumta dhe të ndryshme, me çështje mjaft herë të vështira për t’u dhënë një zgjidhje të prerë. Çështjet e trajtuara në këtë temë janë:

1. Njohuri mbi ndajfoljen lidhur me origjinën, formimin, llojet e kuptimet e tyre.
2. Ndajfoljesimi i disa formave gramatikore dhe i disa togjeve të tipit parafjalë+emër dhe
3. Diskutimi i statusit të ndajfoljeve të sasisë “shumë, pak, mjaft, tepër...” etj

Autorët që janë marrë me studimin e ndajfoljeve e kanë bërë ndarjen e saj në grupe duke u mbështetur mbi kuptimin. Ana kuptimore e ndajfoljeve merret si bazë klasifikimin në ndarjen brenda dy grupeve të mëdha (përcaktore dhe rrethanore).

Një nga studiuesit i cili ka bërë ndarjen e ndajfoljeve është Shaban Demiraj, i cili ka thënë se kemi (ndajfolje të parme, të prejardhura, të përngjitura dhe të përbëra).

---

<sup>9</sup> Fatmir Agalliu, (1995), Gramatika e gjuhës shqipe I – Morfologjia, Tiranë, AShSh, IGjL, fq. 357.

Ndërsa Sheper ka bërë një ndarje tjetër (ndajfolje pyetëse, të pakufijshme, dëftore (të shkakut, të qëllimit), lidhore) duke u mbështetur tek marrëdhënia që kanë me njëra-tjetrën.

2. Ndajfoljesimi i disa formave gramatikore dhe i disa togjeve të tipit parafjalë+emër. Një problem i pasqaruar ende është dhe ai i kalimit të një forme emërore a foljore ose të një togu të tipit parafjalë+emër në klasën e ndajfoljeve. Prandaj për një zgjidhje të drejtë të problemit në shqyrtim të tij është e domosdoshme që më parë të përcaktohen kriteret gjuhësore përkatëse. Duke qenë se pjesët e ligjëratës janë kategori leksiko-gramatikore, për të përcaktuar nëse një formë emërore e foljore ose një togu i tipit parafjalë +emër ka kaluar në klasën e ndajfoljeve apo jo merren parasysh si: a- nga ana leksikore, b- nga ana gramatikore.

Kur një formë emërore ose foljore pëson ndryshime të karakterit leksikor dhe gramatikor dhe merr kuptim e tipare ndajfoljore, me kalimin e kohës ajo fiton aftësinë që të përdoret si ndajfolje.

Diskutimi i statusit të ndajfoljeve të sasisë: “shumë, pak, mjaft, tepër” etj. Diskutimi i çështjeve që kanë të bëjnë me pjesët e ligjëratës kanë një rëndësi të veçantë si nga pikëpamja teorike, ashtu edhe ajo praktike. Në gjuhësinë shqiptare këto çështje deri më sot nuk janë bërë objekt trajtimi në një punim të veçantë. Nëpër gramatikat shkollore të kategorive të ndryshme kategorive të ndryshme është bërë edhe klasifikimi i fjalëve në pjesë ligjëratare, por parimi nga është nisur ky klasifikim në përgjithësi nuk është parashtruar. Për herë të parë parimet e këtij klasifikimi dhe grupimi i mëtejshëm i pjesëve të ligjëratës janë dhënë në tekstin universitar<sup>10</sup>. Në traditën gramatikore të gjuhës shqipe fjalët shumë, pak, aq, kaq, mjaft janë trajtuar edhe si ndajfolje sasive, edhe si përemra, edhe mbiemra të pacaktuar.

Kur përdoren si përcaktorë emrash, për t’i karakterizuar ata nga pikëpamja e sasisë, janë marrë si mbiemra të pakufishëm. Dallimi i tyre nga përemri është bërë mbi bazën e një analize kuptimore të sforcuar dhe sipas parimit të nënkuptimit.

Shtruarja dhe zgjidhja e problemeve të një teme të tillë për gjuhën shqipe, mbështetur në materiale të gjera kërkon një studim të thellë.

---

<sup>10</sup> Shaban Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe 4*, ETMMK-Prishtinë 1967.

## 2.1. Formimi i ndajfoljeve

Kemi një sërë mënyrash të formimit të ndajfoljeve:

Ndajfolje të formuara prej rasash të ndryshme të emrit psh: *ja tha copë ,eci,vrap,ditën,krihem flakesh*. Prej këtyre shembujve kuptojmë se rasat e disa emrave kanë marrë vlerë ndajfoljore<sup>11</sup>. Ndajfolje prej mbiemrash duke iu hequr nyjën (i, e, të) mirë, mirë. (i, e, të) bukur, bukur; gëzueshëm, gëzueshëm, psh: këndoj bukur, punoj pastër, rri drejt, flas kuptueshëm. Këtë rregull e hedh poshtë gramatika e vjetër e Dilo Shaperit dhe Osman Muderrizit, të cilët thonë se mbiemrat dalin nga ndajfoljet dhe jo anasjelltas. Por ky rregull i tyre nuk merret shumë për bazë pasi një kategori e madhe ndajfoljesh të greqishtes së vjetër dhe latinishtes dalin nga mbiemrat me anë të prapashtesës -as për greqishten *kalos agnos* dhe për prapashtesën -tër për latinishten si *prudenter sapienter*. Edhe gjuha shqipe kështu vepron i ndërton disa ndajfolje duke u bazuar tek mbiemrat. Por ka dhe disa raste kur vetë mbiemri ka funksionin e ndajfoljes p.sh: *Ai djalë është i madh*. Të gjitha këto provojnë se ndajfoljet dalin nga mbiemrat dhe jo mbiemrat nga ndajfoljet. Në gjuhën shqipe kemi disa ndajfolje shqipe disa mbiemra që kanë dalë prej ndajfoljeve të kohës, të vendit: *i sot, i sotëm, nesër, i nesërm, afër, i afër, i afërm*. Një tjetër kategori ndajfoljesh formohet nga:

- a) Nga rasa rrjedhore e mbiemrave psh: (*së gjati, së gjëri, së dyti, së afërmi*)
- b) Nga formimi me parafjalën për psh: (*për së afërmi, për së largu, për së gjall*)
- c) Nga përsëritja e ndajfoljeve psh: (*kot së koti, krejt së krejti, pikë së pari!*)

Ndajfoljet e mënyrës të formuara me parashtesën -thi që u ngjitet:

- a) emrave të thjeshtë ( *qirithi, lopthi, arithi, fythi*)
- b) mbiemrave të prejardhur me -im (*kërcimthi, fluturimthi*)
- c) emrave të përngjitur (*hopashalthi, dorashinthi*)
- d) mbiemra të rasës rrjedhore të tyre (*çalthi, së prapthi*)
- e) ndajfoljeve (*tantthi, djeth*)

---

<sup>11</sup> Nushi, Musa, Gjuha e sotme shqipe I, “Shkallët e ndajfoljeve” fq. 202

Kjo parashtesë s' duhet përzjerë me prapashtesën *-th*, me të cilën formohen emra me kuptim zvogëlimi psh: *greqth, lukth*

Ndajfolje mënyre të formuara me prapashtesën *-as*, që u ngjitet:

a) *emrave (barkas, burras, fytas, krahas)*

b) *foljeve (befas, falas, vjedhas)*

c) *mbiemrave (çalas, haptas, lehtas)*

d) *disa fjalëve të përngjitura (ballaballas, dora-doras, symbyllas)*

Kjo prapashtesë ka edhe trajtën e zgjatjes *-aze, -azi*. (*barkas dhe barkazi*).

Kemi edhe ndajfolje mënyre të formuara me prapashtesën- **sht** si: (*burrërisht, vëllazërisht, miqësisht*)

Kjo prapashtesë u ngjitet emrave femëror me- *i* si: (*miqësi, miqësisht, toskëri, toskërisht*).

Përveç kategorive që përmenda më lart kemi dhe një kategori ndajfoljesh që formohen prej dy a më shumë fjalësh të lakueshme e të palakueshme dhe të bashkuara ose jo me parafjalë. Të tilla togje fjalësh me vlerë ndajfoljore janë quajtur lokucione ndajfoljore<sup>12</sup>. Ato mund të dalin:

a) Prej një parafjale dhe një emri, mbiemri ose përemri (*me vrap, me zemër, për ditë, me vend, me mend*)

b) Prej një parafjale dhe gjinisë asnjënjëse të mbiemrit që ka vlerë emri abstrakt (*me të drejtë, më të mirë, ndaj të ngrysur*)

c) Prej 2 emrash të përsëritur (*copa-copa, herë-herë, pika-pika, tufa-tufa*)

d) Prej 2 emrash apo ndajfolje të bashkuar me një parafjalë (*kokë e këmbë, fund e majë, rreth e rrotull, brez pas brezi, derë më derë, sy ndër sy, këmbë përmbi këmbë*)

e) Prej një parafjale dhe një ndajfoljeje (*deri këtu, gjer atje, për tani, për nesër*)

f) Prej 2 ndajfoljesh (*poshtë e lart, sot e mbrapa, para mbrapa*)

Secila nga këta lokucione tregon një relacion kohe, vendi, mënyre por edhe një ndajfolje të thjeshtë.

---

<sup>12</sup> Nushi, Musa, Gjuha e sotme shqipe I, "Shkallët e ndajfoljeve" fq.203



## 2.2. Ndajfoljet rrethanore

Grupi i ndajfoljeve rrethanore është i përdorshëm. Dihet se veprimet ndodhin në kohë dhe në hapësirë dhe si të tilla ato kanë nevojë të përcaktohen në mënyrë sa më të plotë. Ky fakt shpjegon dhe dendurinë e përdorimit të këtyre ndajfoljeve. Kështu veprimet përcaktohen në kohë e në hapësirë jo vetëm me bashkimet parafjalë+emër, nga të cilat kemi mjaft raste kalimi në ndajfolje, por dhe me ndajfolje të thjeshtë e lokucione ndajfoljore. Ndajfoljet rrethanore tregojnë rrethanat, në të cilat kryhet veprimi pa përcaktuar karakterin e cilësisë të tij, ndërsa ndajfoljet cilësorë emërtojnë cilësinë e veprimit<sup>13</sup>.

- a) Ndajfoljet e kohës janë një nëngrup i ndajfoljeve rrethanore. Roli kryesor i tyre është të tregojnë rrethanat në të cilat kryhet veprimi i shprehur nga folja. Ndajfoljet e kohës mund të shprehin raporte të ndryshme kohore të veprimit foljor:
- kohën e saktë të kryerjes të një veprimi lidhur me çastin e ligjërit si: **ditën, natën, dje, sot, etj.** P.sh. *Ç'kishin këta kaurët e Çukasit, që i binin përzishëm, këmbanës dje?*
  - Kohën sa zgjat një veprim si: **gjatë, gjithmonë, gjithnjë, kurdo, përditë, përvit:** P.sh. *Shqipëria kurdo here ka qene e lavdëruar.*
  - Dendurinë e veprimit foljor si: **dendur, ndonjëherë, rrallë, shpesh.** P. sh.
  - Ndajfoljet e kohës **asnjëherë, kurrë, kurrën e kurrës** dalin përgjithësisht vetëm si pjesë të dyta të mohimit, gjymtyra e parë e të cilit mund të jetë një pjesëz mohuese **nuk, s', mos ,pa**.
- b) Ka raste kur ndajfoljet e vendit mund të përcaktojnë edhe kuptimin e një emri jofoljor dhe të një përemri. Këto raste shpjegohen me mos-shprehjen e foljes *jam* në kuptimin *ndodhem*, meqë ajo nënkuptohet lehtë. P.sh. *Sa mirë që u gjende aty, më shpëtove jetën. Po një ndajfolje vendi mund të përcaktojë një emër jofoljor në një renditje të tillë: parafjalë+emër foljor+ndajfoljor.*

Ndajfoljet e vendit mund të tregojnë:

- Vendin ku kryhet një veprim ose ku ndodh një ngjarje lidhur me një pikë të hapësirës. Të tilla si: **aty këtu, atje, këndeje, afër, larg.** P.sh. *Shtëpia e saj ndodhet shumë larg shtëpisë tënde, kështu që duhet të hipesh autobusin për të shkuar atje.*

<sup>13</sup> Shaban Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe 4*, ETMMK-Prishtinë 1967, Fq. 362.

- Disa ndajfolje të tjera vendi tregojnë një vend të palokalizuar me saktësinë e tillë si: vende-vende, diku-diku, diku, gjëkund, gjetkë, gjetiu etj. P.sh. Era kishte hedhur metale dhe vende-vende dëborë ngrihej përpjetë si mal.
- Këtu mund të përfshihen edhe ndajfoljet anëmbanë, anekënd, gjithandej, kudo, tek d. P.sh. Ajo hodhi vështrimin anëmbanë: pa qiellin e kthjellët e të pafund, pa majat e vargmaleve të Gramozit.<sup>14</sup>
- Ashtu si të ndajfoljet e kohës edhe të ndajfoljet e vendit ka disa fjalë, si: *asgjëkund, askund, gjëkund, kund, kurrkund* që përdoren nëpër fjali mohuese si pjesë e dytë përforcuese e mohimit. P.sh. *Astriti s'kishte për të shkuar asgjëkund, po u ngatërrua në këtë muhabet e s'dinte si të dilte. Dielli s'duket kurrkund.*
- Si ndajfolje vendi merren edhe ndajfoljet pyetëse *ku, nga, kur* përdoren nëpër fjali të drejta e të zhdrejta. P.sh.  
*“Kuj i duket balta më e ëmbël se mjalta? Nga je e pse ke ardhur”*

Një vend të veçantë brenda ndajfoljeve të shkakut zënë fjalët *prandaj, andaj*. Këto ndajfolje janë të baras vlershme me togon: *për këtë shkak, për këtë arsye e më rrallë edhe për këtë qëllim*. Ato përdoren edhe në krye të një fjalie kryesore, e cila paraqitet si rrjedhojë e një fjalie shkakore dhe kryejnë në këtë rast një rol rimarrës, ri-përmendesh të shkakut të paraqitur në fjalinë e parë të periudhës.

Këto ndajfolje përdoren shpesh si korrelatë me lidhëzat nënrenditëse shkakore *se e sepse* P.sh. *Sepse e ka përdorur kështu këtë armë të fuqishme, prandaj punën tonë nuk e ka prekur ndryshku*. Lidhur me vendin që zënë ndajfoljet *prandaj, andaj* në fjali duhet shtuar se kjo varet nga qëllimi i thënies. Kur folësi dëshiron ta theksojë në mënyrë të dukshme shkakun, atëherë në fillim të periudhës vjen fjalia shkakore e pastaj vijnë ndajfoljet e shkakut, por të shumtën e herës ato qëndrojnë në krye të periudhës. Ndajfoljet e shkakut mund të shërbejnë për të pyetur thjesht për shkakun që përcakton realizimin e veprimit, si p.sh. *“Pse sot yjet nuk po ndriçojnë”*.

<sup>14</sup> Shaban Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe* 4, ETMMK-Prishtinë 1967, fq.365

Ndajfolja e shkakut pyesin vetëm për veprimet, shprehëse të të cilave janë foljet, pra ato gjenden vetëm pranë foljeve. Përsa iu përket fjalëve *andaj, prandaj*, pa mendimet nuk janë të njëjta tek autorët e ndryshëm. Këto fjalë në fjali të ndryshme herë na dalin si ndajfolje herë na dalin si lidhëza<sup>15</sup>.

---

<sup>15</sup> Gramatika e gjuhës shqipe 1, botim i - Akademisë së Shkencave, kreu VIII, fq.366.

### 2.3. Llojet e ndajfoljeve rrethanore

Autorët që janë marrë me ndajfoljet e kanë bërë ndarjen e tyre në grupe duke u mbështetur mbi kuptimin. Po ana kuptimore e ndajfoljeve merret si bazë klasifikimi në ndarjen brenda dy grupeve më të mëdha. Ndarja e ndajfoljeve në përcaktuese e në rrethanore.

Ndajfolje rrethanore janë ato që tregojnë rrethanat në të cilat kryhet veprimi i shprehur nga folja. P.sh. (*Në fillim Andrea u skuq, pastaj u inatos, por më në fund, duke u përtypur, e pranoi gabimin.*)<sup>16</sup>

Sipas kuptimit që kanë, ndajfoljet rrethanore ndahen në:

1. Ndajfolje kohe
2. Ndajfolje vendi
3. Ndajfolje shkaku

Lidhja e ndajfoljeve rrethanore me fjalët që përcaktojnë, është në përgjithësi e dobët. Me këtë shpjegohet edhe fakti që ato zënë vende të ndryshme në lidhje me fjalët që përcaktojnë<sup>17</sup>.

---

<sup>16</sup> Gramatika e gjuhës shqipe 1, botim i Akademisë së Shkencave, kreu VIII; fq. 359

<sup>17</sup> Po aty. Fq. 360.

### 2.3.1. Ndajfoljet e kohës

Ndajfoljet e kohës emërtojnë një rrethanë kohore, d.m.th., kohën kur kryhet a kohën sa zgjat veprimi ose gjendja e shprehur nga folja ose një emër prejfoljor i nyjësuar. Pra ndajfoljet e kohës përcaktojnë kryesisht foljet dhe emrat prejfoljor, por ato mund të përcaktojnë edhe mbiemrat prejfoljor dhe pjesoret. P.sh. *Mbrëmë ia mbusha mendjen vetes se Luanin e kishte vetëm mik e asgjë tjetër, kurse sot para disa minutave, ato mendime sikur iu tronditën në themel.*<sup>18</sup>

#### Shembuj:

- Fytyra e kolonelit gjithashtu herë pas here ngurosej.<sup>19</sup>
- Ai ankth, në vend që t'i saktësonte gjërat (ishin tetëdhjetë veta që e kishin përjetuar minutë pas minute, ndaj s'kishte vend për hamendje e lajthim), ai ankth, pra, bëri të kundërtën.<sup>20</sup>
- Shoqëruesit kujtuan se po bënte mahi, çka ishte dhe s'ishte e besueshme, pas pak një dite aq të gjatë e plot të papritura.<sup>21</sup>
- Përqaftimet e, natyrisht, mallëngjimi dhe lotët ishin të tillë, saqë fije të tjera hamendjesh nisën të valëvitëshin e sakaq të treteshin aty për aty...<sup>22</sup>
- Mbrëmë sa vinte e ftohej, ai mbështillej më fort me batanije, pastaj me kryet futur në të, kujtonte se këndonte.<sup>23</sup>
- Shiu i imtë herë pas here kthehej në pjalm, duke bërë që dritaret e shtëpive të ngjanin të verbra.<sup>24</sup>
- Dy-tre kalimtarë, që u ndodhën rastësisht, lajmëruan spitalin, që, aty për aty, dërgoi ambulancën e vetme të tij.<sup>25</sup>

<sup>18</sup> Po aty, fq. 362 *Gramatika e gjuhës shqipe 1*

<sup>19</sup> D, G, 41

<sup>20</sup> D, G, 69

<sup>21</sup> D, G, 39

<sup>22</sup> D, G, 40

<sup>23</sup> D, G, 80

<sup>24</sup> D, G, 85

- Kur *mbrëmë* ra mbi qytet, doktor Guramentoja i madh ndjeu ta kaplonte një pikëllim i madh, i panjohur.<sup>26</sup>
- Kështu kishte qenë sidomos fjala e hapjes që iu besua kronistit të vjetër Xivo Gavo, e cila, përveç titullit momental '*Njëmijë vjet zonzëri*', nuk ishte gjë tjetër, veçse leximi i një liste të pafund të zonzave të qytetit, qysh prej vitit 1361 e gjer para një jave.<sup>27</sup>

---

<sup>25</sup> D, G, 111

<sup>26</sup> D, G, 47

<sup>27</sup> D, G, 107-108

### 2.3.2. Ndajfoljet e vendit

Ndajfoljet e vendit tregojnë vendin ku kryhet një veprim a ku ndodh një ngjarje, vendin për ku drejtohet një lëvizje, vendin nga i cili largohet dikush a diçka, vendin nëpër të cilin kalohet. Ndajfoljet e vendit qëndrojnë zakonisht pranë një foljeje, pranë një emri prejfoljor të nyjësuar, pranë një mbiemri prejfoljor e pranë një pjesoreje. Ndajfoljet e vendit mund të tregojnë vendi se ku kryhet një veprim a ku ndodh një ngjarje. P.sh. afër, atje, aty, djathtas, këtu, larg, matanë, përtej, pranë etj. P.sh. **Aty** qëndruan vetëm një natë dhe nuk më kujtohet asgjë prej Podgozhanit, veç babait të Markos<sup>28</sup>.

#### *Shembuj:*

- As gjurmë, as dëshmi nuk kishte përveç dy shenjave të zeza, sipër rrugëve automobilistike, pikërisht te vendi ku mendohej se motoçikleta gjermane ishte kthyer mbropa.<sup>29</sup>
- Zëri i ulët, fare ulët: më ngjalle për të zezën tënde.<sup>30</sup>
- Kështu, te sheshi i Bashkisë, në të dyja anët (majtas e djathtas) e portës së hekurit, vareshin dy flamuj të gjatë, me kryq të thyer në mes.<sup>31</sup>
- Gjithmonë sipas ithtarëve, përfytyrimi i revoles te koka mund të kishte qenë i vërtetë, por kurrësi në atë kah që i ishte besuar.<sup>32</sup>

---

<sup>28</sup> Po aty, fq. 364. *Gramatika e gjuhës shqipe 1*

<sup>29</sup> D. G. 71

<sup>30</sup> D.G. fq. 52

<sup>31</sup> D.G. fq. 73

<sup>32</sup> D.G. fq. 61

### 2.3.3. *Ndajfoljet e shkakut*

Këto ndajfolje nuk janë dalluar si grup më vete në gramatikën e gjuhës shqipe. Ato janë kryesisht vetëm në rastet kur shërbejnë si mjet lidhës i një fjalie të varur me një fjali tjetër. Arsyeja e mosklasifikimit të tyre si një grup më vete ndajfoljesh ka qenë, me sa duket, numri i pakët i tyre dhe fakti që ato përdoren kryesisht në fjalitë pyetëse të drejta e të zhdrejta. Ndajfoljet e shkakut shërbejnë për të treguar a për të pyetur për shkakun e kryerjes së një veprimi. P.sh. **Pse** pushoi muzika?<sup>33</sup>

**Shembuj:**

**Pse** nuk i bie shkurt? – e kishte ndërprerë shefi i madh, këngën me sëmundje dhe, pa e zgjatur, i kishte telefonuar në çast dy doktorëve Guramento, të madhit e të voglit.<sup>34</sup>

---

<sup>33</sup> Po aty, fq. 365. *Gramatika e gjuhës shqipe I*

<sup>34</sup> D, G, 107



## KREU –III-

### 3. Jeta dhe veprimtaria letrare e Ismail Kadaresë



*Fig.1. Ismail Kadare*<sup>35</sup>

Ismail Kadare dhe  
vepra e tij tashmë

njihen mirë në mbarë kontinentin e më gjërë për forcën e saj shprehëse e vlerat autentike që mbart, por që gjithsesi nuk mund të trajtohen veçmas nga kultura e përbashkët evropiane. Nëse do ta kufizonim atë të paktën në shpërndarjen që ajo njeh në hapësirën gjermanike, do të shihnim se për fat, ajo ka gjetur një vend të merituar, falë edhe veprës së një përkthyesi të zellshëm e njohësi të mirë të letërsisë shqipe, me emrin, Joachim Roehm. Ndërsa vit pas viti diskutohet për fituesin e çmimit "Nobel" në letërsi, emri i tij do të jetë gjithnjë në listën e kandidatëve për t'u shpallur fitues. Një popull, i cili për dymijë vjet me radhë, u rezistoi ngritjeve e rënieve të perandorive, dyndjeve të shumë popujve, kryqëzatave, sulmeve e pushtimeve, i dërrmuar nga gjakmarrja, e cila ia dobësonte forcën mbrojtëse, popull që për dymijë vjet me radhë e ruajti dhe e pasuroi gjuhën e vet, të cilën nuk e shkruante, por vetëm e mbante të gjallë në traditë gojore, në këngë; një popull i tillë ofron mjaft enigma, të cilave ia vlen t'u shkosh pas. Kadare e ka bërë këtë, ai i ka parasysh mitet e legjendat e popullit të tij, historinë e shqiptarëve dhe historitë e tyre, diku me patos, por më së shumti, me kthjelltësi e logjikë e pa zbukurime dhe kështu vjen në përfundime interesante e, para së gjithash, me vlera letrare<sup>36</sup>.

<sup>35</sup> <http://www.onufri.com/onufri/en/27-darka-e-gabuar>

<sup>36</sup> Flori Bruqi, (2010), "Triumfi shqiptar" (Historike, letrare, psikologjike, poetike...), RUGOVA ART-Prishtinë, fq. 996

### ***3.1. Darka e gabuar***

Është shkruar mes Malit të Robit (Durrës), Luganos së Zvicrës dhe Parisit gjatë verës dhe është roman i shkrimtarit të madh Ismail Kadare. Është dimrit 2007-2008. Një darkë krejtësisht e pazakontë, me një midis mister, është subjekti i romanit të Kadaresë. Ndonëse i bazuar mbi një ngjarje të vërtetë, që ka trazuar vite më parë një qytet të tërë, dhe ndonëse i hetuar për një kohë tepër të gjatë, herë haptas e më së shumti, në fshehtësi, e vërteta e darkës ka mbetur ende sot e pashpjeguar plotësisht. Kadare në “Darka e gabuar” e përshkruan ankthin e palës së tretë të shqiptarëve ndaj pushtimit gjerman një ankth të veçantë nazik, një maçok të ngopur, mendjemadh dhe disi të pafytyrë. Duke përdorur të tria metaforat, Kadare përshkruan dhe referon në cilësitë e palës së tretë, e cila ndryshe nga dy të parat nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me zhvillimet në qytet – ajo nuk është mbështetëse dhe aleate e askujt. Mbi karakterin egoist dhe paturpësinë e saj referojnë metaforat maçok mendjemadh dhe i pafytyrë. Po këto metafora: maçok i ngopur, mendjemadh dhe i pafytyrë mund të përdoren për të emërtuar drejtpërsëdrejti një njeri i cili ka tiparet e fodullëkut, mosmirënjohjes.<sup>37</sup>

---

<sup>37</sup> Kadare, *Darka e gabuar*, fq. 13.

### **3.2. Ngjarja**

Në këtë roman bëhet fjalë për ngjarjet në qytetin e Gjirokastrës nga pushtimi nazist deri tek vdekja e Stalinit me 1953. Romani fillon me ardhjen e gjermanëve në Shqipëri, me ç'rast pararoja e tyre goditet në kufi nga partizanët, gjë që i zemëron gjermanët, të cilët vendosin ta hedhin qytetin në erë, mirëpo ata ndalin bombardimet pasi që shohin flamurin e bardhë të cilin nuk dihet se kush e kishte ngritur. Mirëpo gjermanët dëshirojnë hakmarrje për goditjen e pararojës prandaj mbledhin 80 njerëz që ti pushkatojnë.

## 4. Përfundim

E realizova këtë punim diplome duke u përpjekur që ta ndërlihdh aspektin artistik me atë gjuhësor nga se janë çështje të lidhura ngushtë me njëra – tjetrën. Kam hulumtuar nga tekste të ndryshme gjuhësore, kurse bazë për këtë studim më ka shërbyer Gramatika e gjuhës shqipe I, së bashku me veprën "Darka e gabuar" të shkrimtarit tonë të shquar Ismail Kadare.

Duke trajtuar këtë temë kam arritur në këtë përfundim atë se:

- Ndajfoljet përdoren rregullisht pranë një foljeje,
- Ndajfoljet afrohen me mbiemrat sepse të dyja emërtojnë tipare dhe cilësi që u referohen foljeve,
- Kam analizuar ndarjen e ndajfoljeve të thjeshta, të prejardhura dhe të përngjitura,
- Kam klasifikuar ndajfoljet sipas kuptimit, pra ato rrethanore,

Pra, gjatë punës sime të temës kam përmendur llojet e ndajfoljeve duke i ndarë ato sipas kuptimit, strukturës dhe shkallës. Po ashtu në përdorimin dhe analizimin e ndajfoljeve rrethanore te "Darka e gabuar", kam arritur që t'i identifikojë të gjitha ndajfoljet rrethanore në këtë roman, për t'i pasqyruar në këtë punim.

## 5. Literatura

- ASHSH, IgjL, Grup autorësh, Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë, 2002.
- Fatmir Agalliu, (1995), Gramatika e gjuhës shqipe I – Morfologjia, Tiranë, AShSh, IGjL.
- Fjalorit Elektronik Shpjegues (FESH).
- Shaban Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe 4*, ETMMK-Prishtinë 1967.
- Gramatika e gjuhës shqipe 1, botim i - Akademisë së Shkencave, kreu VIII.1998
- <http://www.onufri.com/onufri/en/27-darka-e-gabuar>
- Elsie, Robert: "HISTORI E LETËRSISË SHQIPTARE", (Botimi i II), Dukagjini, Pejë 2001
- Ismail Kadare -Vepra-Vëllimi i parë. Sh.b. "Fayard",1993
- [www.ismailkadare.com](http://www.ismailkadare.com); faqe zyrtare e autorit ne Internet
- Ismail Kadare, Darka e gabuar.

## **6. Jetëshkrim**

*Emri dhe mbiemri:* **Miranda Krasniqi**

*Ditëlindja:* **17. 6. 1991**

*Vendlindja:* **Kramovik**

*Shkolla fillore:* **“Mustaf Ibishi”, 2000-2008**

*Shkolla e mesme:* **drejtimi-Gjimnazi i Përgjithshëm “Luigj Gurakuqi” 2008-2012**

*Universiteti i Prishtinës* **“Hasan Prishtina. Fakulteti Filologjik, dega-Gjakovë.**

**Programi Gjuhë shqipe 2013-2017.**